



REPUBLIKA E KOSOVËS – РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 9 shtator 2013
Nr. ref.: MKM468/13

né

Rastin nr. KO108/13

Parashtruesit

Albulena Haxhiu dhe 12 deputetët e tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim kushtetues i Ligjit për Amnistri, Nr. 04/L-209

GYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

**MENDIMI KONKURUES DHE MOSPAJTUES I
GJYQTARIT ROBERT CAROLAN**

Pajtohem me vendimin e shumicës se Projektligji për Amnistri, Ligji nr. 04/L-209, është në pajtim me Kushtetutën dhe se procedurat për miratim ishin në pajtim me Kushtetutën.

Megjithatë, nuk pajtohem me shumicën përkitazi me konkludimin se nenet: 1.1.10; 1.1.11; 1.1.15.10; 1.1.15.11; 1.2.5; 1.2.9.7; 1.3.1; 1.3.5.6 dhe 1.3.5.7, të cilët janë amnisti për personat të cilët kanë mundur të kryejnë vepër penale për asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, zjarrvënia dhe falsifikimi i dokumenteve, nuk janë në pajtim me Kushtetutën.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 65.15 të Kushtetutës, ka të njëjtin autoritet, në diskrecionin e vet legjislativ, për të dhënë amnisti për këto vepra penale, ashtu siç kishte në dhënien e amnistisë për të gjitha veprat për të cilat shumica konkludon se janë në pajtim me Kushtetutën. Edhe pse ekzistojnë kufizime të caktuara sipas traktateve dhe sipas së drejtës ndërkombëtare që kufizojnë autoritetin e kombeve sovrane për të dhënë amnisti për vepra të caktuara, siç janë: gjenocidi, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës, moslajmërimi i veprave penale, dhënia e ndihmës kryesve të veprave penale, asgjësimi dhe dëmtimi i pasurisë, zjarrvënia dhe falsifikimi i dokumenteve ligjore, nuk janë në kategorinë e veprave të ndaluara. Prandaj, nuk ka autoritet në Kushtetutë për të mbështetur këtë dallim.

Në fakt, neni 4 i Kushtetutës parasheh se duhet të ketë një ndarje të pushtetëve ndërmjet degëve të ndryshme të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në mënyrë specifike parasheh, në paragrafin 2, se:

“Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ”

Gjithashtu parasheh, në paragrafin 6, se:

“Gjkata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës”.

Në ushtrimin e autoritetit dhe diskrecionit legjislativ, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar këtë ligj në kohë përafërsisht të njëjtë kur ka nxjerrë Ligjin përratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Nr. 04/L-199. Duket se ky ligj për amnistonë është nxjerrë pjesërisht për të përbushur disa nga kushtet e kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare.

Nëse kryesve të veprave penale, të përcaktuara në Projektligj, duhet t'u jepet amnisti, është vendim i politikave publike që Kuvendi i Republikës, jo Gjkata Kushtetuese, ka autoritet për të vendosur në qoftë se dhe vetëm deri në atë masë që vendimi i politikave publike shkel Kushtetutën. Amnistia e dhënë për këto vepra nuk shkel nenin 46 të Kushtetutës, i cili mbron qytetarët nga privimi arbitrar nga prona, në përgjithësi, as nuk privon palët e treta për të pasur qasje në mjetet civile juridike. Në të vërtetë, nuk modifikon apo ndryshon ligjet civile që do të lejonte të gjithë qytetarët që të shfrytëzojnë mjetet juridike për të mbrojtur të drejtat e tyre pronësore në gjykatat e Kosovës. As nuk shkel ndonjë të drejtë të qytetarëve për të shfrytëzuar mjetet juridike në pajtim me nenin 32 të Kushtetutës e as të drejtën për ndonjë mjet efektiv juridik, në pajtim me nenin 54 të Kushtetutës dhe me nenin 6 e me nenin 13 të Konventës Evropiane.

E drejta për të iniciuar procedurë penale dhe hetimet për vepra penale kundër kujtdo qoftë, është e drejtë që i takon Qeverisë dhe autoritetet e qeveritare, jo qytetarëve privatë. Prandaj, veprat të cilat ligji i lejon të mbrohen me amnistit, thjesht kufizon Qeverinë dhe gjykatat e Kosovës në inicimin ose në shfrytëzimin e procedurave penale, dhe jo qytetarët privatë për inicimin e mjeteve civile ligjore.

Prandaj, këto nene të lartpërmendura të Ligjit për Amnistit, Nr. 04/L-209, nuk shkelin ndonjë të drejtë kushtetuese, dhe kështu janë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Dorëzuar me respekt,


Robert Carolan
Gjyqtar

